



---

**Hapet thirrja për mobilitete stafi të UPT-së,  
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+,  
në Politecnico di Torino (POLITO)**

Në kuadër të programit Erasmus+ dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për mobilitete për stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës në Politecnico di Torino.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:** Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie dhe trajnim.

**Kohëzgjatja e bursave:** 5 ditë për aktivitet dhe 2 për udhëtim, Semestri i II, 24 - 25

**Fusha e studimit:** Të gjitha degët

**Numri total i mobiliteteve:** Staf akademik për mësimdhënie dhe trajnim – 2

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin:**

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës\*;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës\*\*;
- Dokumenti i Mobility Agreement (Staff Mobility for Teaching/Training) për stafin në universitetin pritës\*\*\*.
- Motivation Letter;
- Work Plan;
- English or Italian Language Competency (B2 or higher according to the CEFR)

*\*Plani i mobilitetit, si dhe periudha e propozuar e mobilitetit për stafin, duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore ku aplikanti bën pjesë.*

*\*\*Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobiliteteve si staf në universitetin pritës, paraprakisht duhet të kenë aprovimin nga universitetin pritës (Dekan/Titullar Departamenti ose program studimi/Profesor), për kryerjen e aktivitetit gjatë periudhës së mobilitetit. Ai/ajo do të duhet t'ju dërgojë një dokument paraprak aproves, të cilin do të duhet ta bashkangjitet me dokumentet e tjera për aplikim.*

*\*\*\* Mobility Agreement for Teaching/Training për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi i propozuar që do të kryhet gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

**Afati për aplikim për studentët: Deri më 20 janar 2025, ora 12.00**

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT. Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në e-mail: [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al), [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al)

Pas përfundimit të mobilitetit të stafit, personi pjesëmarrës mobilitet duhet të dorëzojë një raport te departamenti përkatës dhe te Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, lidhur me aktivitetin.